

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Operacioni “Muri i Lartë”/ Arrestohet Bledar Cafi në Shkodër, në kërkim Endrit Dokle - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/operacioni-muri-i-larte-arrestohet-bledar-cafi-ne-shkoder-ne-kerkim-endrit-dokle/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 08:57:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 08:54:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e28147a601af0b3a190794d0479c9304bec82e8f8a6ebff72e75e161558e6ce2
TEKSTI	875c3b89af41053890dce6faf96e11f5c3092f63ccbbd221faa3194a0f6623ba
PAMJA	c7cba698d5b28269f09cf281b154695a39b4f66a807474db2d042823a194f569

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a2c23c4350c705c4e65963a2b10a6d3b2b16e649bd17e4d0d4f373ec74a6062b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aeabf4509e171eed592273ece5cddf4aeb2f22a188459bccfd99accd67acf91
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a2c23c4350c705c4e65963a2b10a6d3b2b16e649bd17e4d0d4f373ec74a6062b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


YOU ARE AT: Home » Operacioni "Muri i Lartë"/ Arrestohet Bledar Cafë në Shkodër, në kërkim Endrit Dokle

AKTUALITET

Demo

Operacioni "Muri i Lartë"/ Arrestohet Bledar Cafë në Shkodër, në kërkim Endrit Dokle

SEPTEMBER 26, 2026



Një 50-vjeçar është arrestuar në Shkodër në kuadër të operacionit policor të koduar "Muri i Lartë", të zhvilluar nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me BKH-në, nën drejtimin e SPAK-ut. Operacioni është finalizuar në orët e para të mëngjesit të sotëm, me qëllim ekzekutimin e masave të sigurisë të caktuara nga Gjykata e Posaçme, si dhe kryerjen e kontrolleve për lokalizimin e një tjetër personi të shpallur në kërkim.

Sipas Policisë së Shtetit, në kuadër të operacionit u kap dhe u arrestua në banesën e tij në Shkodër shtetasi Bledar Cafë, 50 vjeç, lindur dhe banues në Shkodër, i cilësuar nga autoritetet si person me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Për Cafën, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më 25 shtator 2026, ka caktuar masën e sigurimit "Arrest në burg". Ai dyshohet për veprat penale "Trafikim i lëndëve narkotike", kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, si dhe "Grup i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".

Operacioni u zhvillua nga Forcat Speciale RENE, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Drejtoria për Hetimin e Narkotikëve, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër dhe BKH-ja, në zbatim të urdhrat të Prokurorisë së Posaçme dhe vendimit të gjykatës.

Në të njëjtën kohë, efektivët kanë ushtruar kontrolle në ambiente dhe banesa që i përkasin shtetasit Endrit Dokle, alias Indrit Dokle, 43 vjeç, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, i cili është shpallur në kërkim që prej vitit 2024.

Edhe për Doklen, GJKO-ja ka caktuar masën e sigurimit "Arrest në burg" për veprat penale "Trafikim i lëndëve narkotike", kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, "Grup i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".

Sipas Policisë, gjatë kontrolleve Endrit Dokle nuk është gjetur në banesë. Për këtë arsye, strukturat policore vijojnë punën për lokalizimin dhe kapjen e tij.

Operacioni "Muri i Lartë" u zhvillua nën drejtimin e SPAK-ut, në kuadër të hetimeve për veprimtari të dyshuara kriminale të lidhura me trafikun e lëndëve narkotike dhe grupet e strukturuar kriminale.

Endrit Dokle

SHARE.

Postimet e reja

Operacioni "Muri i Lartë"/ Arrestohet Bledar Cafë n...

SEPTEMBER 26, 2026

Houthit sulmojnë Arabinë Saudite me raketa e...

SEPTEMBER 26, 2026

"100% njerëzore"/ Etiketa e re për librat e krijuar p...

SEPTEMBER 26, 2026

EMRI/ Ukrainasi i kërkuar për trafik dro*ë...

SEPTEMBER 26, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç "Delvina Gas" ai...

ALERT në Sloveni për VIPA Flips të Kosovës, kanë përmbajtje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu**Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq****Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare**

Na ndiq

[Facebook](#)[Instagram](#)[YouTube](#)[TikTok](#)

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

[raporto këtu](#)

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.